



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **12 shtator 2025 (e premte)**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **Arbër Zenuni**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuari nënkryetar i komunës, **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë ju të pranishëm! E hapim mbledhjen e **nëntë (9)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2025. Në konsultim me kryetarin e Komunës, kemi përgatitur këtë rend dite:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2026;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, rendin e ditës e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A kemi diçka në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht aprovohet pika e parë.

2. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e buxhetit për vitin 2026:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, nënkryetar, anëtarë të KPF-së! Kam kënaqësinë që para juve të lexoj buxhetin e përgatitur për vitin 2026-2028. Në bazë të qarkores së parë buxhetore, të cilën e kemi diskutuar në kuvend dhe në dëgjime buxhetore, ndërkohë në mes të gushtit ka ardhur edhe qarkorja e dytë buxhetore, e cila nuk ka asnjë ndryshim, me përjashtim 44.000€ që janë tërhequr nga pozicioni i pagave dhe kanë kaluar në investime kapitale. Në bazë të qarkores së dytë buxhetore, më lejoni që t’ju jap të dhënat përfundimtare - preliminare të buxhetit të Komunës së Rahovecit 2026-2028. Buxheti në pozicionin e pagave është 12.454.000, mallra dhe shërbime 2.769.000, komunal 390.000, subvencione 1.000.000€ dhe investime kapitale 4.942.000, që e përbëjnë një buxhet total prej 21.547.000. Te kategoria e subvencioneve i kemi vetëm 1.000.000€ dhe këto ndahen për Drejtorinë e Kulturës, Zyrën e Kryetarit, në Shëndetësi dhe pjesa më e madhe shkon në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë, rreth 500.000€. Në bazë të dëgjimeve buxhetore dhe duke marrë parasysh kërkesat e qytetarëve, e kemi përgatitur edhe listën e projekteve kapitale, një dokument që e kemi para vetes. Në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa, e kam vërejtur që të gjitha kërkesat e paraqitura nga qytetarët janë të mbuluara në listën e projekteve kapitale. Kësaj radhe i kemi 9 projekte të reja kapitale. Te rubrika e tretë, shkruan “i ri”, për projekte të reja. Pra, buxheti për investime kapitale është 4.942.000€ dhe 1.133.000 më i vogël se sa vitin e kaluar. Pse është më i vogël? Ju kam shpjeguar, për shkak të aplikimit të formulës në arsim dhe shëndetësi, sipas ligjit të buxhetit.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë kolegët anëtarë të KPF-së, drejtorë të drejtorive! Drejtor, projektet e reja që janë të vendosura në listën e investimeve kapitale: Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik – hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e komuniteteve, është krejt me zero-zero dhe nuk po specifikohet, do të thotë që nuk ka mjete të ndara. Si projekt i ri: “Ndërtimi i rrethojave në oborret

e shkollave”, kjo kontratë ka qenë aktive edhe në vitet e kaluara dhe këtu përshkruhet si projekt i ri. Projekt tjetër i ri: “Rregullimi i çatisë së amfiteatrit në Dejnë”, nëse nuk gabo, ky projekt ka qenë pjesë e buxhetit dhe pjesë e investimeve kapitale. Projekt i ri: “Kompleksi sportiv, faza e tretë – rregullimi i tribunave, parkingjeve, vendosja e gomës në shtegun e atletikës”. Projekt tjetër: “Hapja e lumit në Opterushë”. Kjo i bie që në vitin 2026 nuk ka shumë projekte të reja, vetëm si emërtime në investime kapitale.

Afrim Limani: Defrim, faleminderit për pyetjet! Në duart tuaja e keni listën e projekteve kapitale për vitin 2025-2026, si dhe projeksionet. Për projektet që janë të buxhetuara me zero, realisht këto projekte janë mbyllur dhe ne duhet t'i pasqyrojmë në listën e projekteve kapitale, sepse e kemi për vitin 2025 kanë qenë të buxhetuara, ndërsa në vitet e tjera jo, por e rëndësishme është që kanë kod buxhetor. I kam vendosur aty si pasqyrë për ta parë gjendjen. Te projektet e reja: Ligji për buxhet dhe financa e lejon që një projekt të futet dy herë në listën e projekteve kapitale dhe në dhjetor është koha që mund ta fusim edhe ndonjë projekt kapital. Projektet që i përmende: “Rrethimi i oborreve të shkollave” është projekt i ri, edhe pse e kemi pasur një projekt të njëjtë, por ai është mbyllur me sukses. Gjithashtu edhe “Ndërtimi i çatisë në palestër”, si dhe disa projekte të tjera që i kemi planifikuar. Faktikisht, janë projekte të reja të buxhetuara për vitin 2026, sepse thesari i ka tërhequr të gjitha mjetet për kontratën kolektive dhe realisht për këto projekte nuk kemi mundur t'i ndjekim as procedurat e prokurimit. “Hapja e lumit në Opterushë” është projekt që është me “buxhetimin me pjesëmarrje” në bashkëpunim me DEMOS-in.

Defrim Kafexhiu: Drejtor, sa para janë shpenzuar deri më tani për sheshin qendror të qytetit, duke marrë parasysh këtë pjesën që e ka komuna për tërheqjen e mjeteve nga thesari, për shkak të kontratës kolektive dhe sa është mbetja deri në përfundim të këtij projekti? A ka komuna mjaftueshëm buxhet për ta përmbyllur sipas afatit të përcaktuar?

Afrim Limani: Fatbardhësisht, thesari këtë projekt nuk e ka prekur dhe këtu mjetet janë shpenzuar, aq sa i kemi pasur të buxhetuara, rreth 1.5 milionë. Ndoshta janë edhe 600.000€ që kanë mbetur, por edhe këto janë të buxhetuara për vitin e ardhshëm.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! A kemi ndonjë pyetje tjetër? Nëse jo, atëherë pikën e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht votohet pika e dytë e rendit të ditës.


3. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: Meqenëse drejtoresha për Punë Inspektuese nuk është këtu, po e pyes nënkryetarin e Komunës, për nismën që Komuna e Rahovecit e ka filluar para një viti, për t'i shpërblyer ata të cilët i lajmërojnë rastet e dëmeve që shkaktohen në mjedis, sidomos të hedhja e mbeturinave. Sa ka qenë efektive kjo dhe sa janë rastet në këtë periudhë të këtij viti, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar?

Nënkryetari: Faleminderit, i nderuari kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, drejtorë, të pranishëm! Prej kur ka filluar kjo iniciativë e shpërblimeve, i kemi pasur diku 4 raste, mirëpo ka shumë që lajmërojnë dhe nuk kërkojnë shpërblim, si dhe mbeten anonim.

Kryesuesi: Faleminderit, nënkryetar! A ka dikush diçka tjetër? Nëse jo, po e përmbylлим mbledhjen e nëntë të KPF-së, shihemi në mbledhjen e rregullt të kuvendit!

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

